



Data: 18.05.2018

Ref.: 435/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më 22 Shtator 2017, mori:

V E N D I M

- I. Pezullohet akreditimi i programit të studimit të Kolegjit "Iliria" për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
 - Juridik Civil, LLM, 60 ECTS.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve në vitin akademik 2017/2018, në programin e studimit të cekur në pikën I të këtij vendimi.

Arsyetimi

- I. Bazuar në kërkesën e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) drejtuar të gjitha Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) për dorëzimin e listave të stafit akademik për të gjitha programet ekzistuese, dhe pas verifikimit nga AKA të dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji "Iliria", u konstatua se programi i cekur në pikën një (I) të këtij vendimi nuk i plotëson kriteret sipas nenit 11, pika 3.2. e Udhëzimit Administrativ (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016) mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës. Sipas UA për Akreditim, neni 11, pika 3.2, për secilin program të studimit IAL-të duhet të kenë të paktën tri staf akademik me marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore Dr.sc. apo ekuivalente me të.
- II. Bazuar në kriteret të cilat parashihen në UA për Akreditim, neni 11, pika 3.2, janë trajtuar gjitha dokumentet të cilat janë dorëzuar nga Kolegji "Iliria" dhe si përfundim është konstatuar që programi i cekur në pikën një (I) të këtij vendimi nuk i ka tre bartës të programit me dokumentacion të rregullt sipas UA për Akreditim neni 11, pika 3.2.
- III. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me datë: 22 Shtator 2017, ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga Kolegji "Iliria" dhe ka konstatuar që programi i cekuar në pikën një (I)

të këtij vendimi nuk i përmbush kriteret e cekura në UA për Akreditim, dhe në këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Bazuar në UA për Akreditim, neni 28, pika 2 dhe 3, AKA mund ta tërheqë akreditimin në raste të caktuara. Sipas këtij neni, AKA mund ta tërheq akreditimin në rast se ka dëshmi se cilësia e ofrimit të programeve të studimit në një ose më shumë fusha për të cilat është dhënë akreditimi është dëmtuar në masë të madhe, dhe në këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Kjo këshillë juridike jepet duke u bazuar në nenin 157 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr.05/L-031, datë: 25 Maj 2016) i cili ka hyrë në fuqi me datë: 21 Qershor 2017. Sipas këtij neni Procedurat administrative të filluara dhe të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar procedurën administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji "Iliria"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

